Kronikë

Vrasja e dyfishtë në Velipojë, policia arreston 2 persona, punonjës në hotelin e autorëve të krimit! Njëri prej tyre u plagos në këmbë (EMRAT)

Janë arrestuar dy persona që dyshohet se kanë bashkëpunuar në ngjarjen e rëndë mbrëmjen e djeshme në Velipojë ku mbetën të vrarë dy veta, Arsid Hoxha dhe Ersild Ishmi. Policia ka vënë në pranga Marjo Pali dhe Zyber Zagradi. Ky i fundit si pasojë e të shtënave mori një plumb në këmbë duke u plagosur. Ndërkohë në kërkim janë ende autorët e vrasjes së dyfishtë, vëllezërit Eduart Frroku dhe Gëzim Frroku.

- **Vrasje e dyfishtë në plazhin e Velipojës! Në kërkim dy vëllezër pronarë të hotel 'Holiday'! Viktimat ishin kunetër me njëri tjetrin! Zanafilla e krimit (EMRAT)**
- **Zbardhen emrat e vëllezërve autorë të krimit të dyfishtë mbrëmjen e sotme në Velipojë, pronarë të një hoteli (EMRAT)**
- **Kush është 33-vjeçari që mbeti i vdekur sot në Velipojë, në qershor kanosi me pistoletë kuzhinierin e një lokali**
- **Velipojë, kanosi me pistoletë kuzhinierin pas një konflikti, shpallet në kërkim 33-vjeçari (EMRI)**



Ngjarja ndodhi afër ujësjellësit Velipojë, 20 gusht 2024

Redaksia
20 Gusht, 10:20 | **Përditësimi: 20 Gusht, 11:10**

Share

Policia e Shkodrës ka vënë në pranga dy persona, që dyshohet se janë bashkëpunëtor në ngjarjen kriminale të ndodhur mbrëmjen e djeshme në Velipojë, ku humbën jetën dy të rinj, Ersild Ishmi dhe Arsid Hoxha.

Sipas informacioneve, ata janë të dy punonjës në hotelin e familjes Frroku, të identifikuar si Marjo Pali, 29 vjeç banues në Shkodër dhe Zyber Zagradi, 26-vjeçu banues në Dibër.

Zagradi u plagos mbrëmjen e kaluar me një plumb në këmbë. Të dy janë përfshirë mbrëmë në përplasjen fizike që përfundoi me dy viktima.

LEXO EDHE:
Vrasje e dyfishtë në plazhin e Velipojës! Në kërkim dy vëllezër pronarë të hotel 'Holiday'! Viktimat ishin kunetër me njëri tjetrin! Zanafilla e krimit (EMRAT)

Autorët e krimit, vëllezërit Eduart dhe Gëzim Frroku janë ende në kërkim nga policia.

> *Këtu 2 shtetas, punonjës në një lokal në afërsi të vendit ku ndodhi ngjarja e mbrëmshme, dyshohet se janë përfshirë në konflikton ndërmjet shtetasve E. F., G. F., A. H. dhe E. I..*
>
> *Shtetasi Zyber Zagradi, rreth orës 23:20, është paraqitur për të marrë mjekim, në spitalin rajonal të Lezhës, i dëmtuar lehtë në këmbë, me armë zjarri. Ai dyshohet se është plagosur gjatë të shtënave me armë zjarri.*
>
> *Shërbimet e Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër dhe të strukturave në varësi të saj, të mbështetura nga grupe të Forcës Kundërtakse të Sigurisë, Njësia Shkodër, vijojnë intensivisht kërkimet për lokalizimin, kapjen dhe vënien në pranga të shtetasve Eduart Frroku dhe Gëzim Frroku', njofton policia.*

Ngjarja e rëndë ka lidhje me një konflikt të ndodhur disa javë më parë, në fund të qershorit në hotelin e dy vëllezërve. Njëri prej kamarierëve të këtij hoteli pati një konflikt të çastit me kuzhinierin.

Për këtë të fundit erdhi në ndihmë edhe Ersil Ishmi. Për kamarierin erdhi në ndihmë edhe Ersild Ishmi dhe 33 vjeçari kanosi me armë zjarri kuzhinierin. Më tej ai u largua nga vendngjarja duke hedhur tej dhe pistoletën dhe që në atë kohë ishte në kërkim nga policia.

Sakaq, konflikti nuk është harruar dhe Ishmi së bashku me kunatin e tij Arsid Hoxha u konfliktuan me pronarët e hotelit, dy vëllezërit Frroku, të cilët vranë dy kunetërit me armë zjarri.

Lajmi ne perditesim...

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 11:08

Vrasja e dyfishtë në Velipojë, Shqiptarja.com siguron fotot e dy autorëve të ngjarjes, vëllezërve Gëzim dhe Edmir Frroku

Foto: Vëllezërit Gëzim dhe Edmir Frroku, pronarët e hotelit 'Holiday' në Velipojë, autorë të vrasjes së dyfishtë

Shqiptarja.com ka siguruar foto e dy autorëve të ngjarjes së rëndë në Velipojë dënë e djeshme ku mbetën të vrarë Arsid Hoxha dhe Ersild Ishmi.

Në foto janë dy vëllezërit Gëzim dhe Edmir Frroku, të cilët kryen vrasjen e dyfishtë mbrëmë jashtë hotelit që ata kanë në pronësi.

G.K/Shqiptarja.com

Share

Ora 10:34

Vrasja e dyfishtë në Velipojë, Shqiptarja.com siguron foton e njërit prej viktimave! Në kërkim ende dy vëllezërit pronarë të hotelit



Foto: Ersild Ishmi, i vrarë dje në Velipojë

Shqiptarja.com siguron foton e Ersild Ishmit, 33 vjeçarit i cili mbeti i vrarë dje në Velipojë, së bashku me kunatin e tij Arsid Hoxha.

Policia ka shpallur në kërkim dy vëllezërit, Gëzim dhe Edmir Frroku, pronarë të hotel 'Holiday' në Velipojë.

33-vjeçari rezulton se më 30 qershor 2024 ka kanosur me armë kuzhinierin e hotelit me Velipojë pasi kishte kanosur kamarierin. 33 vjeçari kishte shkuar në ndihmë të kamarierit duke kanosur kuzhinierin me armë zjarri. Në këtë moment pistoletën ia ka hequr nga dora njëri prej pronarëve të hotel Holiday. Më 14 korrik Ishmi policia kishte arrestuar Ersildin dhe ndaj tij gjykata e Shkodrës kishte caktuar masën e sigurisë 'arrest shtëpiar'

Ngjarja duket se nuk është harruar ngaz 33 vjeçari, i cili ka marrë dhe kunatin e tij Arsid Hoxhën dhe kanë shkuar tek hoteli i dy vëllezërve Frroku ku gjatë konfliktit janë qëlluar me armë.

S.G/Shqiptarja.com

Share

G.K/Shqiptarja.com

TAG: edmir frroku gëzim frroku Zyber Zagradi Marjo Pali Arsid Hoxha Ersild Ishmi velipojë Shkodër

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH.com

Sondazhi i ditës:
Kredimarrësit e këqinj s'do marrin më kredi, si e vlerësoni rregulloren e BSH?

Të mirë | Të keqe | Nuk e di

Lajme të tjera

Asnjë provë për abuzim në tenderë, rikthehet në detyrën e shefit të Rendit në Shkodër, Saimir Rrustemi
19 Gusht, 18:27

Manovra me Jet-Ski në det, përplasen dy italianët në Velipojë! Humb jetën 19-vjeçari, arrestohet kunati i tij! Të dy nën efektin e alkoolit (EMRAT)
19 Gusht, 07:24

Punon 16 orë në ditë për të ndihmuar prindërit! Historia e 14-vjeçarit nga Shkodra që i dërrëzoi portofolin me euro turistes belge
18 Gusht, 18:52

Po bënin manovra në det, përplasen me Jet-Ski dy turistët italianë në plazhin e Velipojës! Njëri prej tyre humb jetën në spitalin e Shkodrës (EMRI)
18 Gusht, 14:27

Pamje/ Festivali i Dritave ndez skenën në Shiroké! Aty ku bashkohen muzika me traditën dhe bukurinë e lëqenit

Ergys Kavaja

18 Gusht, 12:03

Nga jet ski te skafet e gomonet, në 1 javë policia bllokon 32 mjete lundruese nga Ksamili në Koman! Gjobiten drejtuesit
18 Gusht, 11:53

Shndrite n'Shiroké', nis edicioni i parë i festivalit të dritave
17 Gusht, 21:32

Të gjithë bashkë bëjnë mrekullë! Emigrantët mbledhin 440 mijë $, kthejnë në muze kullën e Bajraktarit

Ergys Kavaja

17 Gusht, 15:40

Shkodra e turistëve! Kala, det, Liqen dhe alpe: Keni një thesar, njerëzit të dashur

Ergys Kavaja

17 Gusht, 10:39

Vllaznia në futbollin e femrave kërkon sërish grupet e Champions, përforcohet me portieren Hyska: E lumtur për besimin
17 Gusht, 13:52

Një piano, tezgjah e muzika e oborreve të Shkodrës, Robert Bisha sjell koncertin e veçantë te Liqeni i Shkodrës

Ergys Kavaja

16 Gusht, 20:21

VIDEO/ Lumi Buna 'një copë parajse të fshehur' në Shkodër
16 Gusht, 14:43

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i pasaktësuar i kësaj faqeje